



Viti i VIII-të i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2017

TRENDI I KOLONIVE TË BLETËS MJALTORE NË SHQIPËRI DHE FAKTORËT KËRCËNUES

Manjola Kuliçi

Departamenti i Edukimit, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University

Adresë kontakti: manjola.kulici@yahoo.com

Përmbledhje

Pjalmbuesit dhe polenizimi kanë vlera ekonomike, mjedisore dhe social-kulturore të shumëfishta të njohura në të gjithë botën. Qëllimi ynë për realizimin e këtij studimi ka qenë njohja e faktorëve kërcënues për këta pjalmbues me një rëndësi të madhe, duke e ndihmuar bletarin në identifikimin e burimeve kërcënuese dhe marrjen e masave parandaluese në kohën e duhur. Për të kryer këtë studim, u shpërndanë pyetësorë në 66 parqe në rrethe të ndryshme të Shqipërisë, si dhe u bënë vëzhgime në terren. Vlera mesatare e humbjeve të bletëve në periudhën e fundit të dimrit dhe fillimit të pranverës 2016-2017 ka qenë 30-45%. Në bazë të humbjeve i klasifikuam rrethet në dy grupe: 1) Ato me mesatare të ulët të humbjeve të kolonive (<15%): në Lezhë, Përmet, Berat dhe Sarandë. Specifikisht Berati duket që ka humbjet më të vogla me 10%. 2) Ato me mesatare të lartë të humbjeve të kolonive (>40%): në Bulqizë, Dibër, Tiranë, Librazhd, Korçë, Ersekë, Lushnje dhe Durrës. Ndër faktorët kryesorë që mund të kenë shkaktuar këto humbje dimrin e kaluar, renditen: patogjenët dhe grabitqarët, faktorët mjedisorë dhe praktikat bletërritëse. Megjithëse pati humbje të konsiderueshme dimrin e kaluar, trendi afatgjatë i bletarisë në Shqipëri është në rritje.

Fjalë çelës: *pjalmbues, bletë mjaltëse, humbje, faktorë kërcënues*

TREND OF HONEY BEE COLONIES IN ALBANIA AND THREATENING FACTORS

Abstract

Pollinators and pollination have economic, environmental and socio-cultural values known throughout the world. Our goal for the realization of this study has been the recognition of the threatening factors for these pollinators of great importance, helping beekeepers in identifying threatening sources and taking preventive measures in a timely manner. To complete this study, were distributed questionnaires to 66 parks in different districts of Albania and were made field observations. The average value of bee losses in the late winter period and the beginning of spring 2016-2017 was 30-45%. Based on the losses we classified the districts into two groups. 1. Those with low average of colony losses (<15%): Lezhë, Përmet, Berat and Sarandë. Specifically Berat seems to have the lowest

losses of 10%. 2. Those with high average of colony losses (>40%): Bulqizë, Dibër, Tiranë, Librazhd, Korçë, Ersekë, Lushnje and Durrah. Among the main factors that may have caused these last winter losses we ranked: pathogens and predators, environmental factors and beekeeping practices. Although we had a significant loss during last winter, long-term trend for bees in Albania is growing.

Key words: *pollinator, honey bee, losses, threatening factors*

Hyrje

Shqipëria ka një mjedis dhe kushte klimatike shumë të favorshme për rritjen e një flore të pasur (1). Në rang botëror, afërsisht 90 për qind e specieve bimore të egra që lulëzojnë, varen të paktën pjesërisht, nga pjalmuesit (2). Speciet që varen nga polenizuesit, përfshijnë shumë kultura bujqësore frutore, perime, fara, arvore dhe vajra, të cilat japin pjesën kryesore të mikroushqyesve, vitaminave dhe mineraleve në dietat e njerëzve (2). Speciet pjalmuese kryesore në Shqipëri janë: *Apis mellifera*, *Bombus terrestris*, *Bombus pendulus*, *Anthidium manicatum*.

Numri i bletës mjaltëse perëndimore është rritur globalisht në pesë dekadat të fundit, edhe pse janë shënuar rënie në disa vende evropiane (3). Në Shqipëri, gjatë dekadave të fundit, humbjet vjetore të kolonive të bletëve mjaltore nuk kanë qenë të larta. Vitin e kaluar, fundi i dimrit dhe fillimi i pranverës u përball me humbje të konsiderueshme të kolonive të bletës pothuajse në të gjithë vendin, më shumë për bletarët e mesëm dhe të vegjël, por edhe për bletarët me më shumë se 100 familje. Edhe në duke parë humbjet kolosale të kolonive të bletëve në rang rajoni dhe në rang botëror, si dhe duke u nisur nga humbjet e mëdha që patëm vitin e kaluar, e pamë të nevojshme që të kryejmë një vëzhgim rreth situatës aktuale të bletëve, me qëllim që të përcaktonim shkallën e humbjeve në rrethe, si dhe të rendisim disa nga shkaqet kryesore në mënyrë që kjo humbje të ketë qenë një mësim i mirë për shumë bletarë që kanë qenë indiferentë.

Statusi dhe cilësitë e bletës sonë

Bleta e vendit i takon nënlojit *Apis mellifera carnica*, i cili është i përafërt me këtë nënloj që ndodhet në Itali, Kroaci dhe Serbi (4). Identifikimi i subspecieve zakonisht është bazuar në tiparet morfologjike (5), për këtë arsye edhe identifikimi i bletës sonë është bërë mbi bazën e analizës së 30 tipareve morfologjike të saj (6).

Bleta jonë jeton në sintezë me një numër të madh karakteristikash të mira, disa prej të cilave janë: bletë të pastra, shumë të urta, jo agresive dhe që mund të mbahen në rajone të populluara, kanë sens të mirë të orientimit, janë të afta për t'u adaptuar ndaj ndryshimeve klimatike dhe ndryshimeve të mjedisit. Gjatë dimrit kolonitë tkurren në lëmshe të vegjël dhe kanë zhvillim të shpejtë në pranverë. Ato e fillojnë pjellën në zonat e ulëta të vendit që nga mesi i janarit dhe vazhdojnë deri nga fundi i nëntorit, kurse në zonat malore e fillojnë pak më vonë dhe e ndërpresin pak më herët (7). Mund të gjejnë dhe mbledhin ushqim që herët në mëngjes deri në orët e vona të mbrëmjes. Bleta jonë nuk është aq e prirur për të vjedhur mjaltin, ajo shfaq më pak rrjedhje bletësh nga njëri zgjuar për tek zgjoji fqinj.

Por krahas cilësive të mira, bleta e vendit ka edhe disa mangësi ndër të cilat përmendim: prirjen e tyre të madhe për të roitur nëse janë të mbipopulluara, kalojnë kohë të vështira në motin e nxehtë të verës, mbrohen keq nga vjedhjet e bletëve, si dhe zvogëlojnë prodhimin e pjellës gjatë verës.

Trendi i kolonive të bletës mjaltore në shqipëri dhe faktorët kërcënues

Tiparet fenotipike të bletës sonë

Aparenca e përgjithshme (8): kanë madhësi mesatare, janë elegante, kanë gjymtyrë të gjata.

Ngjyra e kitinës: e errët, por mund të ketë edhe unaza të ngjyrosura më lehtë ose me ngjyrë kafe, si dhe pika në trupin e tyre.

Ngjyra e qimeve: është bletë e errët me qime gri ose kafe.

Tab. 1. Disa tipare të bletës mjaltëse Shqiptare (6)

Tiparet fenotipike	Gjatësia në mm
Gjatësia e gjuhës	6.55 mm
Gjatësia e flatrës së përparme	9.64 mm
Gjerësia e flatrës së përparme	3.28 mm
Indeksi kubital	2.63
Toumentumi	0.782
Piloziteti	0.29
Performanca e mjaltit	E mirë
Vjetore, kg	14 kg / zgjua
Aftësia për të roitur, %	E ulët
Pjelloria, numri i vezëve për 24 orë	1500-2000

Metodat

Metoda që kemi ndjekur për realizimin e këtij studimi ka qenë pyetësi, e shoqëruar me diskutime dhe vëzhgime në terren. Vëzhgimet dhe shpërndarja e pyetësorëve është kryer në 22 rrethe, konkretisht në 3 qarqe për secilin rreth. U kemi shpërndarë pyetësorë bletarëve amatorë dhe bletarëve me qarqe të mëdha të ndihmuar nga specialistë të bletarisë nëpër rrethe. Më tej kemi zhvilluar diskutime me ta për humbjet dhe kolonitë e mbijetuara gjatë dimrit. Ne u përqendruam në shkaqet që çuan në humbje masive gjatë dimrit 2016-2017. Të dhënat afatgjata të popullatës të bletëve të mjaltit janë mbledhur në Shqipëri që nga viti 1990 (9) dhe sipas tyre kemi analizuar dhe trendin e kolonisë së bletës shqiptare.

Tab. 2. Pyetësor për të përcaktuar situatën e bletarisë

Nr. i parkut	Dt. marrjes	Forca e familjes	Zhv.pranver-orrr	Zhv.dimëror	Rend.mes i 3 viteve	Humbjet dimërore	Kërc. nga patogjenet	Kërc. nga grabiçarët	Kërc. nga faktorët mjedisor	Kërc. nga praktikat bletërritëse
1										
2										
3										

Rezultatet

Trendi i Apis mellifera carnica në Shqipëri

Në grafikun 1 kemi paraqitur si ka ndryshuar në Shqipëri, numri i familjeve të bletëve, si dhe prodhimitaria e tyre pas vitit 1990. Pas kësaj periudhe Shqipëria ka pasur një potencial të mirë të bletarisë, privatizimi i sektorit të bletarisë dhe zhvillimi i ekonomisë familjare, shënuan rritje të prodhimit dhe të rendimentit në bletari. Nga 76.000 familje që ishin në 1990, u bënë 85.000 familje në vitin 2000. Sikurse duket nuk ka pasur një hov të madh bletaria në këtë periudhë, më shumë dominohej nga bletari amatore. Ndikim gjatë kësaj kohe mund të kenë pasur edhe faktorët politiko-socialë. Trazirat e vitit '97 u shoqëruan me humbje të konsiderueshme në bletë. Ndërsa gjatë 20 viteve të fundit bletaria u përhap **në të gjithë** vendin, u trefishua në numër. Kjo ka ndodhur nga pasioni dhe tradita për këtë zanat antik. Bletaria shqiptare sot ka mbi 6.500 ferma bletësh me një numër total prej rreth 270,000 koloni bletësh. Trendi afatgjatë për bletarinë në Shqipëri është në rritje.

Numri i kolonive të bletës




Fig 1: Potenciali i bletarisë pas viteve '90

Humbjet vjetore 2016-2017

Në tabelën 3 kemi paraqitur humbjet e kolonive në 23 rrethe të ndodhura në pranverën e këtij viti. Bletarët Shqiptarë kanë raportuar humbje të rreth 40% të kolonive të tyre. Megjithatë, kemi hasur në një mentalitet që duhet përmirësuar (tek një pjesë e mirë e bletarëve), që ishte ai i mosdeklarimit të saktë të humbjeve. Kjo ka ndodhur në disa rrethe që humbjet ishin në përqindje shumë të larta dhe këto shifra zvogëloheshin për arsye të ndryshme. Në rang kombëtar vlera mesatare e humbjeve ka qenë 30-45%, një përqindje kjo e konsiderueshme dhe që përbën një shqetësim.

Tab 3. Humbjet e kolonive te bletëve mjaltëse në pranverën 2016- 2017

Nr	Rrethet	% e humbjeve gjatë dimrit 2016	Raste të rënda
1	Shkodër	35	
2	Malësi e Madhe	35	
3	Lezhë	15	
4	Pukë	30	
5	Kukës	30	Dhe >60-70
6	Bulqizë	>40	
7	Dibër	43	
8	Burrel	25-30	
9	Tiranë	40-50	
10	Elbasan	25	
11	Librazhd	>40	Ka dhe 100 %
12	Gramsh	25-30	
13	Korçë	>40	> 50-90% Voskop>90
14	Ersekë	>40	
15	Përmet	15	
16	Vlorë	25-30	
17	Fier	35	Libofshi mbi 80
18	Lushnjë	35-40	Bubullima mbi.80
19	Berat	10	
20	Sarandë	12	
22	Durrës	>40	

Rezultatet që morëm na lejojnë një klasifikim të rretheve në dy grupe:

1) Ato me mesatare të ulët të humbjeve të kolonive (<15%): Lezhë, Përmet, Berat dhe Sarandë. Specifikisht, Berati duket që ka humbjet më të vogla 10%. 2) Ato me mesatare të lartë të humbjeve të kolonive (>40%): Bulqizë, Dibër, Tiranë, Librazhd, Korçë, Ersekë, Lushnje dhe Durrës. Humbjet më të rënda kanë qenë në rrethet Librazhd, Korçë, Fier dhe Lushnje, kjo për shkak të shumë faktorëve kërcënues, të cilët i kemi renditur më poshtë.

Faktorët kërcënues për popullatat pjalmuese në Shqipëri sidomos gjatë periudhës 2016-2017

Pasi u analizuan rezultatet që morëm, identifikuam disa faktorë mund të kenë ndikuar në humbjet e kolonive, sidomos gjatë këtij viti, duke përfshirë:

1. *Patogjenët* (parazitët, viruset, bakteret, kërpudhat) dhe *grabitqarët*. Shumë patogjenë dhe grabitqarë janë përhapur brenda dhe mes popullatave të llojeve të bletëve të egra dhe të menaxhuara.

Vdekshmëria për shkak të dëmtuesve dhe patogjenëve dominon shpjegimet e rënies së bletës së mjaltit vitin e kaluar.

- a) Kërcënimi kryesor për shëndetin e kolonive të bletës shqiptare vjen nga *Varroa destructor*, e cila është gjithashtu një kërcënim mbarëbotëror. Pushtimi i Varroas që nga korriku i vitit të kaluar, ishte pothuajse galopant, është gjetur në 91.8% të rasteve. Ky problem nuk u mor seriozisht nga të gjithë bletarët, sepse kolonitë nuk u trajtuan në kohën e duhur dhe me trajtime efikase.
- b) *Nosema ceranae* është një parazit invaziv që përbën një kërcënim për popullatat e bletëve Shqiptare: *Nosema ceranae* është më e përhapur, por *Nosema apis* gjendet në 28.7% të rasteve që nga viti 2008 e në vazhdim.
- c) *Patogjenë të tjerë kërpudhorë dhe bakterialë*
Kemi vënë re që kërpudha *Ascosphaera apis* dhe bakteri *Paenibacillus larvae*, sulmojnë stadet larvare të bletëve të mjaltit. P. larva, është shkaktar i pestës amerikane, e cila është gjetur në 4.27% të rasteve, ndërsa pesta evropiane është gjetur në 5.48% të rasteve.
- d) Aktualisht, njihen *viruse* të ndryshme që infektojnë bletët e mjaltit në vendin tonë. Disa nga këto viruse shkaktojnë infeksione asimptomatike dhe në varësi të niveleve të virusit ose në pranisë së stresuesve të tjerë, infeksionet mund të mos zbulohen.
- e) Ndër grabitqarët më të mëdhenj që rrezikuan seriozisht, veçanërisht pjalmuesit e menaxhuar, janë:
 - *Zogu Zaragosa* (ha bletët): gjatë migrimit të këtij viti, ai ka shkaktuar dëme për një muaj.
 - *Vespa germanica*, e cila shkaktonte dëm gjatë periudhës gusht – tetor, por rreziku që vjen prej saj është më i vogël krahasuar me Zaragozën.

2. Faktorët mjedisorë

- a) *Lëndët kimike të aplikuara në bletari*
Shumë kimikate që kanë për qëllim kontrollin e parazitëve ose dëmtuesve të kolonisë, kanë treguar se kanë efekte negative në shëndetin e bletëve të mjaltit. Kërcënimi nga ky faktor është gjetur në 4.5% të rasteve. Përdorimi i antibiotikëve në vendin tonë tani është i ndaluar.
- b) *Lëndët kimike bujqësore (pesticidet)*
Çdo vit, bletët kërcënohen dhe dëmtohen për shkak se përdorimi i pesticideve nuk kontrollohet ashtu siç duhet dhe niveli i përdorimit të tyre nuk është i qartë. Nga pesticidet në Shqipëri, sidomos nga insekticidet, ekziston një nivel rreziku, por nuk është një problem i madh në krahasim me vendet e tjera të botës, sepse nuk ka plantacione që shtrihen në sipërfaqe të mëdha. Shumica e vrasjeve të bletëve kanë ardhur si rezultat i aksidenteve apo aplikimit të pakujdesshëm.
Zyrtarisht pak raste të helmimit janë të raportuara nga shoqatat e bletarisë. I tillë është rasti në pranverën e vitit 2004 në rrethin e Korçës, ku rreth 200 koloni bletësh u dëmtuan nga përdorimi i acaricideve në plantacionet e mollës. Raste të tjera kanë qenë sporadike dhe të ndodhura në koloni shumë të vogla të bletëve.
Neonikotinoidet përdoren shumë në Shqipëri: ato veprojnë si neurotoksina të insekteve. Disa prej tyre mund të kenë shkaktuar efekte të dëmshme subletale tek pjalmuesit, sepse ato mund të grumbullohen në nektarin dhe polenin bimor.
- c) *Ndryshimet e përdorimit të mjedisit*
Zgjerimi i shpejtë i zonave urbane ka ndikuar në shëndetin dhe sasinë e kolonive të bletëve të mjaltit, si në madhësinë e popullatës, rezervat e polenit dhe mjaltit, statusin e

mbretëreshës dhe nivelin e parazitëve dhe sëmundjeve. Fragmentimi i habitatit ka kufizuar pjesët folenizuese për pjalmuesit e egër. Rritja e intensifikimit të bujqësisë (krijimi i monokulturave) ka shkatërruar shumë habitate natyrore në të cilat mbështeten polenizuesit për burimet e ushqimore dhe për fole.

d) *Ndryshimet klimatike*

Ndryshimet klimatike mund të kenë përshpejtuar ritmet e rritjes së dëmtuesve dhe shfaqjen e specieve të reja invazive. Ngjarjet ekstreme klimatike mund të kenë efekte të dëmshme edhe në kulturat bimore dhe në popullatat e pjalmuesve. Temperaturat e larta, periudhat e gjata me reshje të dendura dhe ngricat e vona mund të ndikojnë në aktivitetin e pjalmuesve duke ulur madhësinë e popullatës dhe duke sjellë ndryshime në përhapjen e tyre dhe aktivitetet sezonale. Siç e përmendëm më lart, në vitin 2016, afërsisht 40% e kolonive të bletëve të mjaltit humbën gjatë periudhës së dimrit dhe një nga faktorët mund të ketë qenë ndryshimi i klimës.

3. Praktikrat bletërritëse

a) *Migrimi*. Shumë koloni të bletëve të mjaltore janë lëvizur nga bletarët në zona të ndryshme për të gjetur «kullosa të mira», dhe atje kalojnë verën duke mbledhur mjaltin dhe duke përmirësuar shëndetin e kolonisë. Dhe në këtë mënyrë bletarët mund të kenë ndikuar në shëndetin e një kolonie bletësh sepse lëvizjet dhe shkëmbimet e bletës së vendit midis bletarëve do t'i çojnë ato në kontakt me patogjenë apo me dëmtues të rinj.

b) *Shkëmbimet e gjeneve me vendet fqinje kufitare*. 20 vitet e fundit bleta mjaltëse shqiptare është kërcënuar nga shumë aktivitete sikurse nga importimi i mëmave të huaja. Ka të dhëna të mbarështimit të nënlojit *A.m.ligustica* në Shqipërinë e Mesme (Shoqata e Bletarëve të Shqipërisë, 2013). Në pjesën jugore të Shqipërisë, si në Sarandë apo Gjirokastrë, ka bletarë që vazhdojnë të importojnë mëma nga Greqia. Po kështu është vërejtur futja e nënlojit *A.m.caucasica* në Gramsh, e nënlojit *A.m.macedonica* në Korçë dhe e nënlojit *A.m.carnica* (Sllovene) në Shqipërinë Verilindore (Shoqata e Bletarëve të Shqipërisë, 2004). Këto importe mund të rrisin shumëllojshmërinë gjenetike të popullatës së bletës së vendit, apo mund të kenë ndikuar për futjen e patogjenëve të rinj, pasojat e të cilëve i pamë më sipër.

c) *Moskryerja në kohë e të gjitha shërbimeve teknike*, si dhe moskryerja në nivelin e duhur, pasi bletët mund të hasin me një dimër shumë të ashpër. Fermerët nuk marrin asistencë për trajtime efikase dhe sigurisht, kanë shkaktuar dëme në vitet e fundit.

Përfundime

Megjithëse patëm humbje të konsiderueshme dimrin e kaluar, trendi afatgjatë i bletarisë në Shqipëri është në rritje. Kjo tregon për një zhvillim të madh të bletarisë në Shqipëri. Ndër faktorët kryesorë që mund të kenë shkaktuar humbje të tilla dimrin e kaluar ne renditëm: patogjenët (parazitët, viruset, bakteret, kërpudhat) e grabitqarët, faktorët mjedisorë (lëndët kimike të aplikuara në bletari, pesticidet, ndryshimet e përdorimit të mjedisit, ndryshimet klimatike) dhe praktikrat bletërritëse (migrimi, shkëmbimet e gjeneve me vendet fqinje kufitare, shërbimet teknike). Tendenca e kërcënimeve: Bujqësia është e orientuar drejt diversifikimit rajonal të prodhimeve bujqësore dhe tani nuk paraqet një rritje të kërcënimit për pjalmuesit.

Referenca

1. Nuri Qenan. Rritja e bletës. **Kamëz 1965; 113-128.**
2. BESNet. Trialogu i BES-Net për polenizuesit, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural 2017; 3-4.
3. IPBES. Pollinators, pollinator and food production . 2017; 8-11.
4. Kulici, Manjola., Bajrami, Zyri., Kume Kristaq. Genetic Local Differentiation of *A.m.carnica* Population as well as Subspecies *A.m.macedonica*, *A.m.ligustica*, *A.m.mellifera*, *A.m.caucasica*, in Germany, Alpine Region, Austria, Croatia, Serbia, Northern Kosovo, Albania and Macedonia. *Journal of Natural Sciences Research*. Volumi 4, NO 17. USA 2014.
5. Ruttner Fredrich. Biogeography and taxonomy of honey bees. Springer-Verlag. Berlin 1988; 284 p.
6. Kulici Manjola. Lidhjet gjenetike të popullatave të bletës Shqiptare dhe krahasimi i tyre me popullatat e vëndeve fqinje. Fakulteti i Shkencave të Natyrës. Tiranë 2015; 53-61.
7. Shoqata e bletarëve të Shqipërisë. Bleta. Tiranë 2013; 8-13.
8. Nuri Qenan. Veçoritë morfologjike të bletës së vendit. *Buletini i Shkencave Bujqësore* 1963, 2; 126-150.
9. Ministria e Bujqësisë. 2008. Vjetari statistikore.



SHKENCAT SHOQËRORË

SEKSIONI 2

